



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**SHOQËRIA “ALBPETROL” SH.A.**  
**DREJTORIA E PROKURIMIT DHE ANKANDIT**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Patos, më \_\_\_/09/2023

**PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall**  
**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE**  
**KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Blerje lëndë djegëse e lëngët për përdorim termik civil dhe industrial”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 09000000-3 – Produkte te naftës, lëndë djegëse, energji elektrike dhe burime të tjera të energjisë

VLERA E FONDIT LIMIT: 34,960,000 (tridhjetë e katër milion e nëntëqind e gjashtëdhjetë mijë) Lekë pa TVSH

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Albpetrol sha ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:
  - a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*
  - b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

**2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

**2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):** Kapaciteti ligjor plotësohet duke dorëzuar dokumentat sipas Kriterëve të përgjithshme të pranimit/kualifikimit.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

## **2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

2.2.1. Kopje të certifikuar të bilancit për vitet financiare 2020, 2021, 2022, të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të ligjit nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit, të konfirmuar nga administrata tatimore

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

2.2.1. Vërtetimi për xhiron vjetore për vitet financiare 2020, 2021, 2022, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në ligjin nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

## **2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:**

2.3.1. Furnizime të mëparshme të ngjashme në një vlerë jo më të vogël se: 40 % e fondit limit objekt prokurimi, të realizuara gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

### **Si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkohen të paraqiten:**

Vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

### **OSE**

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 40, pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik". Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është

kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë ne vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

2.3.2 Licencë e vlefshme për tregtimin me shumicë të lëndëve djegëse kodit VIII 1 A, e lëshuar nga autoritetet përkatëse, (kategoria IV-b Solar, ose V-b Mazut, ose III-ç Lëndë djegëse për përdorim termik civil dhe industrial) ose licencë për tregëtimin me pakicë të lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë dhe AK të sigurohet se ofertuesi është i licencuar në kryerjen e aktivitetit të vet për ofrimin tek AK të karburanteve.

2.3.3 Fletë analizë të lëshuar nga ISHTI ose raport testimi nga prodhuesi për lëndën djegëse me përmbajtje sulfuri jo më tepër se 0.5 % ndaj peshës sipas kodit doganor 27101962, 27101966 e cila duhet të jetë lëshuar brenda tre muajve nga data e publikimit të procedurës.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 40, pika 6 gërma c, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Ky kriter shërben për të treguar se karburanti i ofruar është në përputhje me standartin dhe plotëson specifikimet teknike të kërkuara.

2.3.4 Vërtetim teknik të lëshuar nga Organet e Miratuara të Vlerësimit të Konformitetit, shoqeruar me Leje mjedisore sipas legjislacionit në fuqi të lëshuar nga QKL, Akt-Teknik të lëshuar nga PMNZH, dhe Police Sigurimi me një nga shoqerite e sigurimeve që operojnë në Shqipëri, për depozitat e lënës djegëse që verteton kapacitetet depozituese dhe rezervat e operatorit ekonomik, për të garantuar vazhdimësi në furnizim, sipas kërkesave të autoritetit kontraktor.

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 40, pika 5 gërma ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Ky kriter shërben për të treguar se ofertuesit i kanë kapacitetet teknike lidhur me ekzekutimin e kontratës.

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të ketë në pronësi apo me qera të pakten 1 (një) autobot me kapacitet mbajtës jo më pak se 10 m<sup>3</sup>,

- **Pronesia** e autobotit të vertetohet si më poshtë:  
Ofertuesi duhet të paraqesë, lejen e qarkullimit të mjetit rrugor në emer të ofertuesit, siguracion të vlefshëm, akt kolaudimi të vlefshëm, taksat vjetore.
- **Mjeti i marre me qira sipas pikes se mesiperme,** vertetohet me kontraten e qiramarrjes ose të huapërdorjes të lidhura para noterit, me afat vlefshmerie që përfshin edhe afatin e zbatimit

te kesaj kontrate per kete objekt prokurimi dhe e shoqeruar me dokumentacionin, lejen e qarkullimit te mjetit rrugor, siguracion te vlefshem, akt kulaudimi te vlefshem, taksat vjetore.

- Per autobotin, operatori ekonomik duhet te paraqese edhe dokumentat e meposhtem :
  - Çertifikate per transport mallrash te rrezikshme, leshuar nga Autoriteti perkates i caktuar me ligj.
  - Pashaporten e cisternes per autobotin.

**Shenim:** Për përmbushjen e këtij kriteri operoret ekonomik ofertues duhet te paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojces nr.8.

Ndërsa operatori ekonomik i renditur i pari duhet të dorëzoje pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme eshte përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 40, pika 5 gërma ç, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Ky kriter shërben për të treguar kapacitetin teknik lidhur me mjetet në dispozicion të ofertuesit për të realizuar me sukses kontratën pasi sipas termave të kontratës ofertuesit duhet të ofrojnë shërbim për furnizim me lëndë djegëse në lëng në depozitat e përcaktuara nga AK.

## II. Argumentimi i specifikimeve teknike

**Shënim:** *Specifikimet teknike jane hartuar nga specialistet e fushes pranë Autoritetit Kontraktor të cilët kanë njohuri të posacme për objektin e prokurimit. Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.*

### Njësia e Prokurimit: